



FAKULTETI I EDUKIMIT

AGJENDA INSTITUCIONALE E KËRKIMIT SHKENCOR

2026-2030

Miraturar nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit: 01 Qershor 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE (2026–2030)	4
FUSHAT PRIORITARE	5
EKIPET E HULUMTIMIT	6
<i>Korniza e zbatimit</i>	7
<i>Monitorimi dhe vlerësimi</i>	8
FUSHA I: MËSIMDHËNIA, TË NXËNIT DHE DIDAKTIKAT LËNDORE	10
FUSHA II: FËMIJËRIA E HERSHME: EDUKIMI, ZHVILLIMI DHE MIRËQENIA E FËMIJËS	11
FUSHA III: POLITIKAT ARSIMORE, UDHËHEQJA DHE QEVERISJA E REFORMËS	12
FUSHA IV: GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA DHE DREJTËSIA SOCIALE NË ARSIM	13
FUSHA V: TRANSFORMIMI DIGJITAL, INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE INOVACIONI NË ARSIM	14
NDËRLIDHJA NDËRMJET FUSHAVE PRIORITARE, EKIPEVE TË HULUMTIMIT DHE KONTRIBUTI I DEPARTAMENTEVE	15

HYRJE

Kjo Agjendë Institucionale e Kërkimit Shkencor (2026–2030) shërben si një kornizë orientuese dhe dinamike për priorizimin, koordinimin dhe fuqizimin e kërkimit institucional në fushën e shkencave të edukimit. Duke u mbështetur në nismën e Grupeve Kërkimore (Research Clusters), të lansuar në vitin 2021 dhe të strukturuar formalisht në vitin 2026, kjo Agjendë shënon kalimin nga përpjekjet e fragmentuara individuale drejt një veprimtarie kërkimore të koordinuar, ndërdepartamentale, ndërdisiplinore dhe të orientuar drejt ndikimit. Dokumenti identifikon fusha prioritare dhe tematike që do të orientojnë zhvillimin e projekteve, publikimeve, studimeve MA/PhD, partneriteteve dhe kontributit të Fakultetit në politikat arsimore. Prioritetet e paraqitura nuk përbëjnë listë shtruese të të gjitha temave të mundshme; ato shënojnë drejtimet me rëndësi të lartë institucionale për periudhën 2026–2030, ndërsa agjendat e detajuara do të zhvillohen nga vetë ekipet e hulumtimit.

Shkencat e edukimit trajtojnë një nga fushat më vendimtare për zhvillimin shoqëror, demokratik dhe ekonomik të vendit. Arsimi nuk është vetëm sistem i transmetimit të dijes, por edhe mekanizëm themelor për formimin e qytetarëve, për ndërtimin e kohezionit social, për avancimin e barazisë dhe për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Për këtë arsye, kërkimi në shkencat e edukimit nuk ka vetëm vlerë akademike, por edhe funksion të drejtpërdrejtë publik, pasi ndihmon në kuptimin e sfidave reale të sistemit arsimor dhe në prodhimin e zgjidhjeve të mbështetura në dëshmi.

Në kontekstin e reformave të vazhdueshme në arsim, të ndryshimeve teknologjike, të nevojës për përfshirje më të madhe dhe të kërkesave në rritje për cilësi dhe llogaridhënie, roli i një qasjeje institucionale ndaj kërkimit shkencor bëhet edhe më i rëndësishëm. Një qasje e tillë mundëson përcaktimin e prioriteteve të përbashkëta, ndërtimin e një kulture të qëndrueshme kërkimore, lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien dhe studimet doktorale, si dhe krijimin e vazhdimësisë në prodhimin e njohurive. Në vend të një aktiviteti të shpërndarë dhe të varur nga angazhime individuale, qasja institucionale krijon kushte që kërkimi shkencor të zhvillohet si përgjegjësi kolektive dhe si funksion strategjik i Fakultetit.

Kjo qasje është po ashtu e rëndësishme sepse e forcon pozicionin e Fakultetit si aktor i besueshëm në dialogun me politikëbërësit, institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin akademik. Kur kërkimi shkencor organizohet në mënyrë institucionale, ai fiton më shumë koherencë tematike, kapacitet më të madh për bashkëpunim ndërdisiplinor, më shumë potencial për financim të jashtëm dhe ndikim më të qartë në zhvillimet arsimore në vend.

Në këtë kuptim, Agjenda Institucionale e Kërkimit Shkencor shërben jo vetëm si dokument planifikues, por si instrument për konsolidimin afatgjatë të identitetit kërkimor të Fakultetit.

Strategjia udhëhiqet nga pesë parime themelore:

- Rigoroziteti shkencor dhe integriteti akademik
- Hulumtimi i mbështetur në dëshmi dhe i orientuar drejt ndikimit
- Bashkëpunimi ndërdepartamentar dhe ndërdisiplinor
- Integrimi i kërkimit shkencor me studimet MA dhe PhD
- Fleksibiliteti, ndërkombëtarizimi dhe perspektiva krahasuese

Fakulteti synon të pozicionohet si pikë kombëtare referente për kërkimet shkencore në edukim në Kosovë, duke u angazhuar njëkohësisht në mënyrë aktive në rrjete akademike evropiane dhe globale.


OBJEKTIVAT STRATEGJIKE (2026–2030)

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE (2026–2030)



VIZIONI I HULUMTIMIT NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

Hulumtime cilësore, me ndikim dhe të qëndrueshme që përmirësojnë arsimin, praktikën dhe politikat për një shoqëri më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe inovative.



FUSHAT PRIORITARE

Kjo Agjendë përcakton *fusha prioritare orientuese* për zhvillimin e hulumtimit në Fakultetin e Edukimit gjatë periudhës 2026–2030. Ajo nuk synon të përfshijë të gjitha temat e mundshme të hulumtimit në Fakultet, as të kufizojë iniciativat individuale ose ndërdisiplinore që mund të zhvillohen gjatë periudhës së zbatimit. Përkundrazi, fushat prioritare shërbejnë si bosht institucional për koordinimin e kapaciteteve, zhvillimin e projekteve, rritjen e cilësisë së prodhimit shkencor dhe forcimin e ndikimit akademik, profesional dhe publik të Fakultetit.

Fushat prioritare janë formësuar mbi bazën e profilin akademik të Fakultetit, programeve studimore, ekspertizës hulumtuese dhe nevojave zhvillimore të Fakultetit dhe të departamenteve. Çdo departament kontribuon në një ose më shumë fusha prioritare përmes stafit akademik, doktorantëve, studentëve të nivelit MA, projekteve ekzistuese dhe partneriteteve institucionale. Në këtë mënyrë, fushat prioritare funksionojnë si hapësira ndërdepartamentale ku bashkohen kontributet e stafit akademik, ekipeve hulumtuese, studiuesve të rinj dhe partnerëve të jashtëm rreth temave me rëndësi të përbashkët institucionale.



Brenda këtyre fushave, krijohen ekipe të ndryshme hulumtuese, të cilat zhvillojnë tema më specifike, përgatitin produkte të synuara dhe ndërtojnë forma bashkëpunimi në përputhje me kapacitetet dhe interesat akademike. Një ekip mund të kontribuojë kryesisht në një fushë prioritare, por mund të lidhet edhe me disa fusha njëkohësisht, veçanërisht kur temat kërkimore prekin çështje ndërdisiplinore si përfshirja, teknologjia, didaktikat lëndore, fëmijëria e hershme, politikat arsimore ose drejtësia sociale. Përmes kësaj qasjeje, Fakulteti synon të gjenerojë hulumtime me ndikim shkencor, publikime cilësore, projekte të financuara, rekomandime për politika arsimore, raporte dhe analiza institucionale, si dhe produkte profesionale që mbështesin përmirësimin e praktikës arsimore në Kosovë.

EKIPET E HULUMTIMIT

Ekipet e hulumtimit përbëjnë platformat kryesore organizative për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore në Fakultetin e Edukimit, në përputhje me fushat prioritare të përcaktuara në Agjendën Institucionale të Kërkimit Shkencor. Ato bashkohen rreth një fushe prioritare, një orientimi të përbashkët hulumtues ose një teme specifike që mund të lidhet me disa fusha prioritare njëkohësisht. Në këtë kuptim, ekipet e hulumtimit janë mekanizma fleksibil që e bëjnë të mundur lidhjen ndërmjet departamenteve, fushave prioritare dhe produkteve konkrete kërkimore.


Ekipet janë konceptuar si struktura tematike, ndërdepartamentale dhe ndërdisiplinore, të cilat kontribuojnë në prioritetet hulumtuese të Fakultetit, nxisin bashkëpunimin akademik dhe krijojnë vazhdimësi në zhvillimin e projekteve, publikimeve, dhe angazhimeve shkencore. Ato nuk janë njësi të mbyllura dhe nuk zëvendësojnë departamentet; përkundrazi, shërbejnë si hapësira bashkëpunimi ku kontributet e departamenteve, stafit akademik, studiuesve të rinj, doktorantëve, studentëve MA dhe partnerëve të tjerë mund të organizohen rreth çështjeve me rëndësi të përbashkët institucionale.

Secili ekip hulumtues udhëhiqet nga një udhëheqës i ekipit, i cili ka rol koordinues, organizativ dhe zhvillimor. Udhëheqësi i ekipit kujdeset për orientimin e punës hulumtuese, koordinimin e anëtarëve, identifikimin e mundësive për projekte dhe financim, përgatitjen e publikimeve dhe produkteve profesionale, si dhe përfaqësimin e ekipit në raport me organet e Fakultetit dhe partnerët e jashtëm. Në përbërje të ekipeve mund të përfshihen stafi akademik, studiuesit e rinj, doktorantët, studentët MA dhe, sipas nevojës, bashkëpunëtorë të tjerë të angazhuar rreth temave specifike të hulumtimit.

Secili ekip do të zhvillojë agjendën e vet të detajuar hulumtuese, do të përcaktojë temat specifike, produktet e pritshme dhe format e bashkëpunimit, në përputhje me fushat prioritare të Agjendës, kapacitetet akademike dhe mundësitë për partneritete institucionale..

STRUKTURA E EKIPIT HULUMTUES

Organizimi, rolet dhe funksionimi i ekipit hulumtues në Fakultetin e Edukimit



**FUNKSIONI I PËRGJITHSHËM**

Ekipi funksionon si hapësirë e koordinuar për udhëheqje akademike, bashkëpunim hulumtues dhe zhvillim të iniciativave shkencore.



Përgjegjësitë kryesore të udhëheqësit të ekipit përfshijnë:

- koordinimin e planit vjetor të punës së ekipit;
- organizimin e takimeve të rregullta;
- nxitjen e përgatitjes së projekteve, publikimeve dhe paraqitjeve në konferenca;
- përfshirjen e hulumtimeve të nivelit MA dhe PhD brenda ekipit; si dhe
- raportimin periodik për progresin, sfidat dhe rezultatet e arritura.

Ekipet mbajnë takime të rregullta periodike, të cilat shërbejnë për të diskutuar progresin e punës, për të identifikuar iniciativa të reja, për të ndarë gjetje paraprake, për të planifikuar aplikime të përbashkëta dhe për të forcuar kulturën e bashkëpunimit hulumtues. Përveç takimeve të përgjithshme, ekipet hulumtuese mund të zhvillojnë takime më të shpeshta pune sipas nevojave të projekteve konkrete. Në këtë mënyrë, ekipi nuk funksionon vetëm si strukturë formale, por si një komunitet aktiv hulumtues, ku puna kolektive, reflektimi akademik dhe prodhimi i dijes zhvillohen në mënyrë të organizuar dhe të qëndrueshme.

Përmes këtij organizimi, Fakulteti synon që ekipet hulumtuese të shërbejnë si mekanizma për forcimin e kapaciteteve institucionale, për rritjen e cilësisë dhe dukshmërisë së hulumtimit, si dhe për krijimin e një kulture të qëndrueshme shkencore të bazuar në bashkëpunim, përgjegjësi të përbashkët dhe ndikim të matshëm.

Korniza e zbatimit

Zbatimi i Agjendës do të mbështetet në një mekanizëm fleksibil institucional, ku prioritetet e përbashkëta përkthehen në plane pune të ekipeve dhe në iniciativa konkrete të departamenteve.

- Hartimi nga secili ekip i një agjende të detajuar hulumtuese dhe i një plani vjetor pune me tema, produkte dhe përgjegjësi të qarta.
- Hartëzimi periodik i kontributeve të ekipeve dhe departamenteve në secilën fushë prioritare, për të siguruar pjesëmarrje të gjerë dhe koherencë institucionale.
- Integrimi i hulumtimeve MA dhe PhD me agjendën e ekipeve, duke mbështetur zhvillimin e studiuesve të rinj dhe mentorimin e strukturuar.
- Zhvillimi i projekteve ndërdepartamentale dhe ndërkipore, veçanërisht në temat ku ndërthuren didaktika, gjithëpërfshirja, teknologjia, politikat, fëmijëria e hershme dhe dimensionet sociale të arsimit.
- Përdorimi strategjik i të dhënave të gjeneruara nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare për publikime shkencore, rekomandime politikash dhe produkte profesionale.
- Aplikime të synuara për financim të jashtëm dhe krijim partneritetesh me institucione akademike, shkolla, komuna, ministri dhe organizata ndërkombëtare.
- Organizimi i seminareve hulumtuese, forumeve të politikave dhe aktiviteteve të shpërndarjes së gjetjeve, me qëllim që rezultatet e hulumtimit të përdoren në praktikë dhe vendimmarrje.

Monitorimi dhe vlerësimi

Progresi do të monitorohet çdo vit nga zyra e Prodekanit për Shkencë dhe Zhvillim.

Raportimi vjetor i ekipeve do të fokusohet në realizimin e studimeve; publikimet dhe citimet; projektet e financuara; përfshirjen e stafit dhe të studentëve MA/PhD; produktet profesionale dhe rekomandimet e politikave; bashkëpunimet ndërkombëtare; kontributet në reforma, kurrikula dhe praktikë shkollore; si dhe dëshmitë se si hulumtimet e Fakultetit është përdorur nga institucionet, shkollat dhe partnerët.

Monitorimi nuk do të fokusohet vetëm në numrin e produkteve, por edhe në cilësinë, përdorimin dhe ndikimin e tyre në praktikë, politikëbërje dhe zhvillim institucional.

Raportet vjetore do të përdoren edhe për të rishikuar prioritetet, për të identifikuar fusha të reja të mundshme dhe për të mbështetur zhvillimin e ekipeve të reja kur ekziston nevoja shkencore dhe kapaciteti institucional.



FUSHAT PRIORITARE SIPAS AGJENDËS INSTITUCIONALE

FUSHA I: MËSIMDHËNIA, TË NXËNIT DHE DIDAKTIKAT LËNDORE

Fusha e hulumtimeve në mësimdhënie, të nxënësve dhe didaktikën lëndore përfshin studimin e proceseve të mësimdhënies dhe të nxënësve, zhvillimin e praktikave pedagogjike dhe didaktike, si dhe transformimin e njohurive disiplinore në përvojë efektive dhe kuptimplotë të të nxënësve. Kjo fushë synon avancimin e cilësisë së arsimit përmes qasjeve inovative, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi, duke promovuar zhvillimin e kompetencave kyçe, mendimit kritik, kreativitetit dhe zbatimit të dijes në kontekste reale dhe ndërdisiplinore, përfshirë edhe qasjen STEAM.

Prioritetet hulumtuese

- **Mësimdhënia e bazuar në kompetenca dhe constructive alignment:** Hulumtimi i projektimit dhe harmonizimit të rezultateve të të nxënësve, aktiviteteve mësimore dhe praktikave të vlerësimit në përputhje me qasjen e bazuar në kompetenca.
- **Didaktikat lëndore dhe ndërdisiplinore:** Hulumtimi i proceseve të mësimdhënies dhe të nxënësve në fusha të ndryshme disiplinore, si dhe zhvillimit të qasjeve ndërdisiplinore në arsim.
- **STEAM dhe të nxënësve ndërdisiplinor:** Studimi i integritit të shkencës, teknologjisë, inxhinierisë, arteve dhe matematikës përmes qasjeve të bazuara në hulumtim, projekte, dizajn dhe zgjidhjes së problemeve.
- **Hulumtimi në veprim dhe mësimdhënësi hulumtues:** Hulumtimi i praktikave reflektuese, hulumtimit në veprim dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve në funksion të përmirësimit të mësimdhënies, të nxënësve dhe praktikave të bazuara në dëshmi.
- **Vlerësimi i kompetencave dhe i të nxënësve:** Hulumtimi i praktikave bashkëkohore të vlerësimit, përfshirë vlerësimin formativ, vlerësimin e kompetencave dhe të performancës në detyra komplekse, autentike dhe ndërdisiplinore.
- **Inovacioni didaktik dhe zhvillimi i praktikës mësimore:** Hulumtimi i qasjeve dhe modeleve inovative të mësimdhënies, si dhe i integritit pedagogjik të teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në proceset e mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit.

Pyetje orientuese të hulumtimit

1. Si zbatohet qasja e bazuar në kompetenca dhe (constructive alignment) në kontekste të ndryshme lëndore dhe arsimore?
2. Cilat praktika pedagogjike dhe didaktike kontribuojnë në zhvillimin e të nxënësve të thelluar, mendimit kritik dhe kreativ, si dhe në zbatimin e njohurive në situata autentike dhe reale?
3. Si mund të integrohet STEAM në mënyrë kuptimplotë dhe të qëndrueshme në arsimin fillor, arsimin e mesëm dhe në programet e përgatitjes së mësimdhënësve?
4. Cilat modele të të nxënësve hulumtues dhe të bazuar në kërkim forcojnë kompetencat ndërdisiplinore të nxënësve?
5. Si mund të ndërliken didaktikat lëndore me çështje reale, lokale dhe globale përmes qasjeve ndërdisiplinore dhe kontekstualizimit të të nxënësve?
6. Cilat praktika të vlerësimit mbështesin më mirë të nxënësve e bazuar në kompetencë, zhvillimin e performancës dhe reflektimin mbi të nxënësve??
7. Si zhvillohen kompetencat didaktike të mësimdhënësve për të planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar mësimdhënie ndërdisiplinore?
8. Si mund të përdoren teknologjitë digjitale dhe inteligjenca artificiale për të mbështetur proceset e mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit?
9. Çfarë roli kanë reflektimi profesional, bashkëpunimi dhe hulumtimi në veprim në përmirësimin e praktikës mësimore dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve?

Ndikimi i synuar

Kjo fushë synon të forcojë rolin e Fakultetit të Edukimit në zhvillimin e praktikave mësimore cilësore, inovative dhe të mbështetura në dëshmi. Përmes hulumtimeve mbi mësimdhënie, të nxënësve, didaktikat lëndore dhe integritet STEAM, Fakulteti synon të kontribuojë në përmirësimin e përgatitjes së mësimdhënësve, zhvillimin e modeleve të reja të mësimdhënies ndërdisiplinore, forcimin e kompetencave bazë dhe avancimin e vlerësimit për të nxënësve. Fusha pritët të gjenerojë rekomandime për programe të përgatitjes së mësimdhënësve, materiale mbështetëse për praktikën në klasë, projekte hulumtuese ndërdisiplinore dhe publikime që lidhin didaktikat lëndore me inovacionin pedagogjik dhe nevojat reale të sistemit arsimor.

FUSHA II: FËMIJËRIA E HERSHME: EDUKIMI, ZHVILLIMI DHE MIRËQENIA E FËMIJËS

Edukimi në fëmijëri të hershme është themelor për arritjet akademike dhe zhvillimin e potencialit njerëzor. Kjo fushë e pozicionon EFH-në jo vetëm si fazë përgatitore për shkollim, por si periudhë kritike zhvillimore që kërkon koherencë sistemore ndërmjet kurrikulës, zhvillimit të fëmijës, kompetencave të edukatorit, metodologjive pedagogjike, dhe angazhimit të familjes. Fusha integron zbatimin e kurrikulës, planifikimin dhe vlerësimin, zhvillimin dhe mirëqenien, identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme, përgatitjen e edukatorëve, bashkëpunimin me familjet, si dhe modelet e qeverisjes dhe sigurimit të cilësisë.

Prioritetet hulumtuese

1. **Zbatimi i kurrikulës, vëzhgimi, planifikimi dhe dokumentimi** (zbatimi i kurrikulës së re të EFH-së; strategjitë pedagogjike të bazuara në kompetenca; praktikat e vëzhgimit, planifikimit dhe dokumentimit; harmonizimi ndërmjet synimeve të kurrikulës dhe praktikës së përditshme; dokumentimi pedagogjik)
2. **Loja, metodologjitë pedagogjike dhe të nxënit aktiv** (loja si formë themelore e të nxënit dhe zhvillimit; metodologjitë me fëmijën në qendër; të nxënit përmes eksplorimit, ndërveprimit, tregimit, artit, lëvizjes dhe përvojave praktike; organizimi i mjediseve që nxisin kuriozitetin, kreativitetin, bashkëpunimin dhe zgjidhjen e problemeve; roli i edukatorit në mbështetjen, zgjerimin dhe dokumentimin e lojës së fëmijëve)
3. **Vlerësimi, identifikimi i hershëm dhe ndërhyrjet në mjedise pedagogjike** (sisteme të përshtatshme të vlerësimit; monitorimi i trajktoreve zhvillimore; identifikimi dhe intervenimi i hershëm në mjedise edukative; integrimi i rezultateve të vlerësimit në planifikim pedagogjik të individualizuar)
4. **Politikat sistemore dhe qeverisja** (strukturat qeverisëse të EFH-së; modelet e financimit dhe strategjitë e zgjerimit; standardet e cilësisë dhe mekanizmat e llogaridhënies; integrimi i EFH-së në korniza më të gjera të reformës arsimore)
5. **Kompetencat dhe përgatitja e edukatorëve** (zhvillimi i kompetencave në vlerësim, planifikim, dokumentim; përdorimi i metodologjive aktive dhe të bazuara në lojë; kapaciteti i edukatorëve për praktikë gjithëpërfshirëse; formimi i identitetit profesional të edukatorit; praktikë reflektuese; modelet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional)
6. **Mjedisi, familja dhe mirëqenia** (cilësia e mjediseve fizike dhe pedagogjike të të nxënit; kornizat e mirëqenies së fëmijës; partneriteti me familjet si bashkë-edukatore; qasjet ekologjike ndaj ndërhyrjes; përfshirja e prindërve në procesin pedagogjik dhe ndërtimi i vazhdimësisë ndërmjet përvojave në familje dhe institucion)

Pyetje orientuese të hulumtimit

1. Si interpretohet dhe zbatohet kurrikula e re e EFH-së në kontekste të ndryshme institucionale?
2. Si i formësojnë praktikat e vëzhgimit dhe dokumentimit proceset e vendimmarrjes pedagogjike?
3. Si mund të mbështesin në mënyrë efektive sistemet e vlerësimit të fëmijës të nxënit e individualizuar dhe përfshirjen?
4. Cilat metodologji pedagogjike mbështesin më së miri të nxënit aktiv, eksplorimin, kreativitetin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve? Si përdoret loja si formë themelore e të nxënit, zhvillimit dhe mirëqenies në institucionet e EFH?
5. Cilat modele të identifikimit/ndërhyrjes janë më efektive në kontekste të bazuara në institucione parashkollore?
6. Si zhvillohen kompetencat e edukatorëve në vlerësim, përfshirje dhe dokumentim?
7. Cilat modele të qeverisjes dhe financimit sigurojnë zgjerim të barabartë dhe sigurim të cilësisë në EFH?
8. Si ndikojnë partneritetet me familjet në rezultatet zhvillimore dhe mirëqenien e fëmijës?

Ndikimi i synuar

Kjo fushë synon të forcojë bazën shkencore për zhvillimin cilësor të EFH, duke prodhuar dëshmi mbi zbatimin e kurrikulës, lojën, metodologjitë pedagogjike, vëzhgimin, dokumentimin, vlerësimin, zhvillimin e fëmijës, dhe bashkëpunimin me familjet. Hulumtimet në këtë fushë do të kontribuojnë në përmirësimin e praktikave pedagogjike, forcimin e kompetencave të edukatorëve, zhvillimin profesional dhe sigurimin e cilësisë në EFH. Në nivel sistemi, fusha synon të informojë zbatimin e kurrikulës, politikat për zgjerimin e qasjes, qeverisjen, dhe partneritetet me familjet, komunitat dhe institucionet kombëtare.

FUSHA III: POLITIKAT ARSIMORE, UDHËHEQJA DHE QEVERISJA E REFORMËS

Reformat ndërmjetësohen përmes udhëheqjes dhe qeverisjes. Kjo fushë studion mënyrën se si politika hartohet, interpretohet dhe zbatohet. Ajo e shqyrton udhëheqjen dhe qeverisjen si forca ndërmjetësuese ndërmjet dizajnit të politikave dhe praktikës në klasë. Njëkohësisht, e vendos reformën arsimore të Kosovës në raport me debatet krahasuese evropiane dhe synon të pasurojë debatin kryesor evropian për politikat arsimore.

Prioritetet hulumtuese

1. **Praktikat e udhëheqjes dhe menaxhimit arsimor** (*praktikat e udhëheqjes mësimore; planifikimi strategjik dhe proceset e vendimmarrjes; planifikimi dhe monitorimi i përmirësimit të shkollës; menaxhimi i burimeve dhe llogaridhënia në nivel shkolle; rolet udhëheqëse në zbatimin e kurrikulës dhe reformës*)
2. **Zhvillimi organizativ dhe kultura shkollore** (*proceset e të nxënësve organizativ; kultura shkollore dhe orientimet vlerore; bashkëpunimi profesional dhe komunitetet e praktikës; menaxhimi i ndryshimit dhe qëndrueshmëria e reformës; efikasiteti kolektiv i mësimdhënësve; klima institucionale dhe ndikimi i saj në performancë*)
3. **Hartimi i politikave arsimore, zbatimi dhe realitetet e qeverisjes** (*formulimi i politikave dhe analiza e ciklit të politikës; zbatimi i politikave në nivel shkolle dhe komune; strukturat qeverisëse dhe kornizat rregullative; mekanizmat e autonomisë dhe llogaridhënies; hendekët në zbatimin e reformës; modele krahasuese të qeverisjes; kultura e politikëbërjes kurrikulare në kontekste në zhvillim*)
4. **Politikat e zhvillimit të mësimdhënësve dhe praktikat e të nxënësve profesional** (*politika e arsimit fillestar të mësimdhënësve, standardet dhe harmonizimi me praktikën; kornizat e të nxënësve profesional; sistemet e mentorimit dhe të induksionit; modelet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional; politika e identitetit të mësimdhënësve; sistemet e ruajtjes dhe motivimit të mësimdhënësve*)

Pyetje orientuese të hulumtimit

1. Si i zbatojnë drejtuesit e shkollave rolet e tyre në praktikë, si marrin vendime dhe si i interpretojnë proceset e zhvillimit dhe reformës?
2. Si formësohet efektiviteti organizativ i shkollës nga udhëheqja dhe kultura profesionale, dhe cilat kushte mbështesin zhvillimin e cilësisë?
3. Cilat modele menaxheriale dhe të qeverisjes janë më të përshtatshme për sistemet arsimore që veprojnë me autonomi të kufizuar institucionale?
4. Çfarë e karakterizon kulturën e politikëbërjes në Kosovë dhe si janë zbatuar dhe ndërmjetësuar në praktikë reformat arsimore në nivel sistemi, kurrikule, organizimi shkollos dhe mësimdhënësi, dhe çfarë mund të kontribuojnë këto përvoja në debatet kryesore evropiane për politikat arsimore?
5. Si ka evoluar politika dhe praktika e përgatitjes së mësimdhënësve në raport me zhvillimet vendore dhe ndërkombëtare, dhe cilat qasje janë më efektive për përgatitjen e mësimdhënësve në kontekstin e Kosovës?

Ndikimi i synuar

Kjo fushë synon të prodhojë analiza të besueshme mbi mënyrën se si politikat arsimore hartohen, interpretohen dhe zbatohen në kontekstin e Kosovës, duke ndihmuar në kuptimin më të thellë të proceseve të reformës, qeverisjes dhe vendimmarrjes në arsim. Përmes hulumtimeve mbi udhëheqjen, menaxhimin, planifikimin strategjik, llogaridhënien dhe kulturën profesionale në institucionet arsimore, fusha do të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve udhëheqëse në shkolla, komuna dhe institucione përmes kornizave, rekomandimeve dhe produkteve profesionale të bazuara në dëshmi. Në këtë mënyrë, Fakulteti do të forcojë rolin e tij si partner këshillëdhënës në reformat kombëtare dhe si kontribues aktiv në debatet krahasuese evropiane për politikat arsimore.

FUSHA IV: GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA DHE DREJTËSIA SOCIALE NË ARSIM

Kjo fushë bashkon hulumtimet mbi gjithëpërfshirjen, mbështetjen e nxënësve, barazinë dhe drejtësinë sociale në arsim. Ajo e trajton përfshirjen jo vetëm si çështje të aftësisë së kufizuar, por si parim më të gjerë institucional që lidhet me qasjen, pjesëmarrjen, përkatësinë, mirëqenien, rezultatet e të nxënësve dhe drejtësinë arsimore për të gjithë nxënësit. Në këtë kuadër, fusha përfshin edhe dimensionin social të arsimit, edukimin për vlera, edukatën qytetare, kulturën demokratike të shkollës dhe rolin e shkencave shoqërore në kuptimin e marrëdhënieve ndërmjet arsimit, shoqërisë, pjesëmarrjes dhe kohezionit social.

Prioritetet hulumtuese

- **Praktikat pedagogjike gjithëpërfshirëse dhe mbështetja e nxënësve:** Mësimdhënia e diferencuar, planet individuale të të nxënësve, mbështetja në klasë, identifikimi i hershëm, ndërhyrja e hershme dhe bashkëpunimi me familjet.
- **Barazia në qasje, pjesëmarrje dhe rezultate arsimore:** Pabarazitë sociale në arsim dhe ndikimi i tyre në qasje, pjesëmarrje, dhe arritje arsimore, duke përfshirë pabarazitë socio-ekonomike, gjinore, etnike, gjuhësore, gjeografike dhe digjitale.
- **Klima shkollore, përkatësia dhe mirëqenia:** Ndjenja e përkatësisë, marrëdhëniet në shkollë, siguria, mirëqenia socio-emocionale dhe kulturat mbështetëse të të nxënësve, kohezioni social, marrëdhëniet ndërmjet grupeve dhe roli i shkollës në ndërtimin e besimit social.
- **Edukimi demokratik, qytetaria dhe vlerat:** Edukimi i bazuar në vlera, kompetencat qytetare, pjesëmarrja e nxënësve, zëri i nxënësve dhe kultura demokratike e shkollës, të drejtat e njeriut, përgjegjësia qytetare, dialogu, toleranca, solidariteti dhe respekti për diversitetin.
- **Shkencat shoqërore, identiteti dhe drejtësia sociale në arsim:** Roli i shkencave shoqërore në zhvillimin e mendimit kritik, ndërgjegjësimit qytetar, kuptimit të historisë, kulturës, identitetit, diversitetit dhe proceseve shoqërore që ndikojnë në përvojën arsimore të nxënësve.
- **Politikat gjithëpërfshirëse dhe drejtësia sociale në nivel sistemi:** Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse, koordinimi ndër-institucional, roli i udhëheqjes shkollore dhe hendeve ndërmjet politikës dhe praktikës, si dhe mënyra se si politikat arsimore adresojnë barazinë, dimensionin social dhe edukimin qytetar.

Pyetje orientuese të hulumtimit

- Si konceptualizohet dhe zbatohet gjithëpërfshirja në shkollë dhe në përgatitjen e mësimdhënësve?
- Cilat praktika pedagogjike mbështesin pjesëmarrjen, të nxënësve dhe mirëqenien e nxënësve me nevoja të ndryshme?
- Si zbatohen mësimdhënia e diferencuar, planet individuale të të nxënësve dhe format e tjera të mbështetjes në klasë?
- Cilat barrierat ndikojnë në qasjen, pjesëmarrjen dhe rezultatet arsimore të nxënësve nga grupet e marginalizuara?
- Si ndikojnë pabarazitë socio-ekonomike, gjinore, etnike, gjuhësore, gjeografike dhe digjitale në përvojën shkollore?
- Cilat forma të klimës shkollore/ kulturës institucionale krijojnë kushte më gjithëpërfshirëse, demokratike dhe mbështetëse?
- Si integrohen edukimi për vlera, edukata qytetare dhe kompetencat demokratike në kurrikulë, mësimdhënie dhe jetën e përditshme të shkollës?
- Çfarë roli luajnë shkencat shoqërore në zhvillimin e mendimit kritik, ndërgjegjësimit qytetar, kuptimit të diversitetit dhe pjesëmarrjes demokratike të nxënësve?
- Si ndikon dimensionin social i arsimit në përkatësinë, pjesëmarrjen, kohezionin social dhe rezultatet arsimore të nxënësve?

Ndikimi i synuar

Kjo fushë synon të fuqizojë rolin e Fakultetit në hulumtimet mbi gjithëpërfshirjen, barazinë, drejtësinë sociale dhe dimensionin social të arsimit. Përmes saj, Fakulteti do të kontribuojë në zhvillimin e praktikave pedagogjike më mbështetëse, politikave më të drejta dhe kulturave shkollore më gjithëpërfshirëse, demokratike dhe të orientuara nga vlerat. Hulumtimet në këtë fushë priten të gjenerojnë rekomandime për përgatitjen e mësimdhënësve, zhvillimin profesional, mbështetjen e nxënësve me nevoja të ndryshme zhvillimore dhe sociale, si dhe për zvogëlimin e pabarazive në qasje, pjesëmarrje dhe rezultate arsimore. Në të njëjtën kohë, fusha do të kontribuojë në forcimin e edukimit qytetar, edukimit për vlera dhe kulturës demokratike të shkollës.

FUSHA V: TRANSFORMIMI DIGJITAL, INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE INOVACIONI NË ARSIM

Transformimi digjital po i riformëson sistemet arsimore në nivele epistemologjike, pedagogjike dhe institucionale. TIK-u dhe Inteligjenca Artificiale nuk janë më vetëm mjete plotësuese, por elemente strukturore që po rridefinojnë mësimdhënien, të nxënësve dhe vlerësimin. Kjo fushë e trajton transformimin digjital si një fenomen sistemor në arsim, duke hulumtuar mënyrën se si TIK-u, IA-ja, robotika dhe shkathhtësitë digjitale riformësojnë të nxënësit lëndor, dizajnin mësimor, përfshirjen dhe përgatitjen e mësimdhënësve. Fusha shkon përtej integritetit teknik të teknologjisë, drejt kuptimit të implikimeve epistemike, njohëse dhe qeverisëse të digjitalizimit.

Prioritetet hulumtuese

1. **TIK-u dhe të nxënësit lëndor specifik** (ndikimi i platformave digjitale në transformimin e proceseve arsimore, pedagogjisë dhe ekosistemit të të nxënësit; mësimdhënia hulumtuese e mbështetur nga teknologjia; mbështetja digjitale për të kuptuarit e leximit)
2. **Digjitalizimi i mësimin** (integrimi digjital ndërdisiplinor; të menduarit kompjuterik dhe zgjidhja e problemeve; të nxënësit e bazuar në kërkime të mbështetur nga mjetet digjitale)
3. **Inteligjenca Artificiale në arsim** (vlerësimi formativ i asistuar nga IA; përdorimi etik i IA-së në përgatitjen e mësimdhënësve; literacy në IA dhe kompetenca kritike digjitale; ndikimi i të nxënësit të mbështetur nga IA në arsim)
4. **Robotika dhe të nxënësit përmes përvojës** (robotika për angazhim dhe hulumtim; robotët humanoidë në mjedise bashkëpunuese të të nxënësit; aplikimet gjithëpërfshirëse të robotikës)
5. **TIK-u në arsimin për nevojat të veçanta** (teknologjitë asistive; kornizat e qasshmërisë digjitale; Dizajni Universal për të Nxënë dhe diferencimi digjital)

Pyetjet prioritare të hulumtimit

1. Si ndikon transformimi digjital në praktikën pedagogjike, angazhimin e nxënësve dhe rezultatet e të nxënësit në kontekste të ndryshme arsimore?
2. Si po i interpretojnë dhe zbatojnë mësimdhënësit AI literacy dhe TIK-un brenda kurrikulave të bazuara në kompetenca?
3. Cilat modele të mjediseve mësimore të mbështetura nga robotika e forcojnë hulumtimin dhe bashkëpunimin?
4. Si mund të përmirësojnë teknologjitë asistive pjesëmarrjen dhe rezultatet e të nxënësit për nxënësit me nevojat të veçanta?
5. Cilat kornizat të qeverisjes e rregullojnë më së miri përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të IA-së në arsim?
6. Sa janë të përgatitur mësimdhënësit para shërbimit dhe në shërbim për transformimin digjital dhe cilat boshllëqe strukturore vazhdojnë të ekzistojnë?

Ndikimi i synuar


Fusha synon të mbështesë transformimin digjital të arsimit përmes përdorimit të përgjegjshëm, etik dhe pedagogjikisht të qëllimshëm të TIK-ut, inteligjencës artificiale dhe mjeteve digjitale. Përmes hulumtimeve mbi kompetencën digjitale, AI literacy, teknologjitë asistive, qasshmërinë digjitale dhe integrimin e teknologjisë në programet e përgatitjes së mësimdhënësve, fusha synon të kontribuojë në zhvillimin e kornizave institucionale, rekomandimeve dhe praktikave që mbështesin mjedise më gjithëpërfshirëse, më fleksibile dhe më inovative të të nxënësit. Në këtë mënyrë, Fakulteti synon të rrisë kapacitetin e tij për inovacion arsimor, partneritete ndërkombëtare dhe publikime shkencore në fushën e teknologjisë arsimore.

NDËRLIDHJA NDËRMJET FUSHAVE PRIORITARE, EKIPEVE TË HULUMTIMIT DHE KONTRIBUTI I DEPARTAMENTEVE

Ekipet hulumtuese janë konceptuar të funksionojnë si grupe analitike të ndërlidhura, dhe jo si njësi tematike të izoluar. Ato përbëjnë platforma ndërdepartamentale përmes të cilave artikuloen prioritetet institucionale të Fakultetit dhe bëhet i dukshëm kontributi i departamenteve akademike në zhvillimin e hulumtimit. Secili departament kontribuon në një ose më shumë fusha/ekipe përmes ekspertizës së stafit akademik, programeve studimore, mentorimit të hulumtimeve MA dhe PhD, projekteve ekzistuese dhe partneriteteve institucionale. Në këtë mënyrë, ekipet nuk zëvendësojnë departamentet, por i lidhin ato rreth prioriteteve të përbashkëta dhe krijojnë kushte për gjenerimin e publikimeve shkencore, projekteve hulumtuese, rekomandimeve për politika, produkteve profesionale dhe bashkëpunimeve kombëtare e ndërkombëtare.

KONTRIBUTI I DEPARTAMENTEVE NË EKIPE TË HULUMTIMIT

Si kontribuojnë departamentet në fushat prioritare dhe si gjenerohet hulumtimi institucional



Ndërlidhja ndërmjet fushave prioritare është thelbësore për koherencën e kësaj agjende. Mësimdhënia, të nxënit, STEAM dhe didaktikat lëndore lidhet ngushtë me transformimin digjital, inteligjencën artificiale dhe inovacionin në arsim, sidomos në zhvillimin e qasjeve ndërdisiplinore, të nxënit të bazuar në kërkim dhe përdorimin pedagogjik të teknologjisë. Gjithëpërfshirja, barazia dhe drejtësia sociale në arsim ndërthuret me politikat arsimore, udhëheqjen dhe qeverisjen e reformës, pasi çështjet e përfshirjes, barazisë, klimës shkollore dhe pjesëmarrjes varen si nga praktikatat pedagogjike, ashtu edhe nga politikat dhe strukturat institucionale. Fusha e fëmijërisë së hershme krijon ura të natyrshme me fushat e tjera prioritare, duke integruar zhvillimin e fëmijës, mirëqenien, përgatitjen profesionale, përfshirjen, vlerat dhe vazhdimësinë ndërmjet fazave zhvillimore. Në këtë kuptim, projektet kryesore institucionale dhe nismat e reformës shërbejnë si platforma empirike që gjenerojnë të dhëna, pilotojnë ndërhyrje dhe forcojnë ndikimin kumulativ të hulumtimit në nivel institucional.

FUNKSIONALIZIMI I EKIPEVE TË HULUMTIMIT

Ekipet e hulumtimit funksionalizohen përmes mekanizmave fleksibil që mundësojnë mobilizimin e interesave akademike, kapaciteteve departamentale dhe mundësive për projekte shkencore. Ato mund të formohen:

- me vetiniciativë të stafit akademik dhe studiuesve kur kolegët identifikojnë interesa të përbashkëta hulumtuese rreth një teme, fushe prioritare apo problemi arsimor me rëndësi shkencore dhe institucionale.
- nga departamentet, në përputhje me profilin e tyre akademik, programet studimore, nevojat për zhvillim të kurrikulave, mentorimin e studentëve MA/PhD ose prioritetet profesionale që dalin nga puna e departamentit.
- si përgjigje ndaj ftesave të hapura për aplikime në projekte shkencore, programe kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit, si dhe thirrjeve për bashkëpunim nga institucione partnere.
- nga niveli i Dekanatit, veçanërisht kur Fakulteti synon të aplikojë për projekte me financim të jashtëm, të zhvillojë konsorciume ndër-institucionale, të përgatisë produkte strategjike për politika arsimore ose të mobilizojë ekspertizë ndërdepartamentale për tema me rëndësi të veçantë institucionale.

Në të gjitha rastet, ekipet krijohen rreth fushave prioritare të Agjendës, por mund të kontribuojnë edhe në më shumë se një fushë kur temat janë ndërdisiplinore.

Koordinimi i përgjithshëm i funksionalizimit të ekipeve bëhet nga Prodekani për Shkencë dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Dekanin, udhëheqësit e departamenteve dhe udhëheqësit e ekipeve hulumtuese.

Ky koordinim përfshin identifikimin e mundësive për financim, nxitjen e bashkëpunimit ndërdepartamentar, mbështetjen e aplikimeve për projekte, përcjelljen e progresit të ekipeve dhe sigurimin që puna hulumtuese të jetë në përputhje me prioritetet institucionale të Fakultetit. Kjo bëhet me qëllimin që funksionalizimi i ekipeve nuk mbetet proces i rastësishëm, por bëhet pjesë e një mekanizmi të organizuar për zhvillimin e hulumtimit shkencor, rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e ndikimit institucional.